



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:049212

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05636980

KE.nr.2638/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë – Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit PANDORA A/S, me seli në Havneholmen 17-19 DK-1561, Kopenhagë - Danimarkë, i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga REACT U. A Amstelveenseëg 864, Holandë si bartës i së drejtës, e cila sipas autorizimit përfaqësohet nga Shoqëria e Avokatëve ‘‘Vokshi&Lata’’, me avokat Florin Latën, kundër të paditurit ‘‘Gold & SilverVlera 2’’ Sh.P.K me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati Avni Leci, me seli të zyrës në Prishtinë, për shkak të padisë për shkelje të Markës Tregtare, jashtë seancës me datën 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësit PANDORA A/S, me seli në Havneholmen 17-19 DK-1561, Kopenhagë - Danimarkë, e cila përfaqësohet nga REACT U. A Amstelveenseëg 864, Holandë si bartës i së drejtës, e cila sipas autorizimit përfaqësohet nga Shoqëria e Avokatëve ‘‘Vokshi&Lata’’, me avokat Florin Latën.
- II. Detyrohet pala paditëse që të paguajë shpenzimet procedurale palës së paditur edhe atë në shumën totale prej 509.00eurove (pesëqind e nëntë euro).

III. ABROGOHET Aktvendimi i datës 04.01.2023 me të cilin është aprovuar pjesërisht propozimi i propozuesit ‘‘Pandora-A/A’’, me seli në Danimarkë për caktimin e masës së sigurisë.

A r s y e t i m

Paditësi PANDORA A/S, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur padi kundër te paditurit për shkak të shkeljes së Markës Tregtare me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, këto të parashtuara në padinë e datës 02.11.2022.

Gjykata ka kryer trajtimin paraprak të padisë dhe ka ftuar palët ndërgjyqëse ne seancë dëgjimore me datë 16.12.2022, në të cilën seancë palët ndërgjyqëse janë deklaruar lidhur me pretendimet e tyre si dhe pretendimet e palës kundërshtare, kurse me datën 04.01.2023 ka marrë aktvendim me numër KE.2638/22 me të cilin ka aprovuar pjesërisht propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, ndërsa pas kësaj ka vazhduar me trajtimin e çështjes sipas padisë duke caktuar seancën e radhës me datën 03.04.2024, në orën 10:00.

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij me datën 29.03.2024 ka paraqitur në formë të shkruar parashtresë për tërheqje të padisë, duke theksuar se meqenëse nga gjykata është caktuar masa e sigurisë me të cilën të paditurit i është ndaluar ekspozimi, shitja apo në çfarë do forme tregtimi i produkteve të cilat mbajnë markën tregtare ‘‘Pandora’’, pala paditëse nuk ka më interes juridik të vazhdohet procedura e iniciuar, andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë ta konsiderojë të tërhequr.

Në seancën e caktuar në ditën dhe orën e lartcekur ka prezantuar i autorizuari i palës së paditurit i cili ka dhënë pëlqimin për tërheqje të padisë dhe ka kërkuar nga gjykata shpenzimet e procedurës kontestimore të krijuara deri më tani dhe atë për përpilimin e përgjigjes në padi shumën prej 104.00 (njëqind e katër euro) dhe për përfaqësimin e 3 (tri) seancave gjyqësore përfshirë edhe seancën e datës 03.04.2024 shumën prej 405.00 (katërqind e pesë euro) e që gjithsej në total ka kërkuar shumën prej 509.00 (pesëqind e nëntë euro).

Meqenëse rrethanat faktike kanë ndryshuar që nga vendosja e masës së sigurimit dhe duke pasur parasysh parashtresën për tërheqjen e padisë të të autorizuarit të propozuesit të masës, të datës 29.03.2024, gjykata erdhi në përfundim se arsyet e paraqitura dhe të provuara me rrethanat e ndryshueshme janë të mjaftueshme për shfuqizimin e masës së sigurisë.

Andaj, gjykata në vështrim të dispozitave të nenit 261 par. 1 të Ligjit për procedurën Kontestimore (LPK), pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, jashtë seancës me datën 11.04.2024 ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi nga deklaratimet e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit kuptohet që pala nuk ka interes juridik për ta trajtuar këtë çështje me tutje në gjykatë.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.2638/22, datë 29.04.2024

Gjyqtari
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa vetëm sa i përket pikës II dhe III të dispozitivit, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, Dhomave të Shkallës së dytë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.